



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 718/ 10 prot.,

Datë 03 .04.2026

V E N D I M
Nr. 473 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03 .04.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 412/2026, datë 24.03.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, Nr. REF-77633-02-26-2026, me objekt: “Blerje bojra per printera dhe fotokopje” me fond limit 8,333,333.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Ankimues: Operatori ekonomik “Marketing Distribution” SHPK me NIPT J72124001N dhe adresë: *Autostrada Tiranë -Durrës km 10.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fier, me adresë: *Lagjja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave

“Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

I.1. Në datë 24.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 412/2026, ku vendosi:
[...]

- 1. Të mbyllë çështjen, për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing Distribution” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-77633-02-26 2026, me objekt: “Blerje bojra per printera dhe fotokopje” me fond limit 8,333,333.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.*
 - 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing Distribution” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-77633-02-26-2026, me objekt: “Blerje bojra per printera dhe fotokopje” me fond limit 8,333,333.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier .*
 - 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, dhe vendimit të KSHA si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
 - 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.*
 - 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Marketing Distribution” SHPK.*
 - 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 - 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë..*

1.2. Me shkresën nr. 2554/17 prot., datë 30.03.2026, protokolluar me tonën nr. 718/6prot., datë 01.04.2026 autoriteti kontraktor, ka dërguar informacion për procedurën e “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-77633-02-26-2026, me objekt: “Blerje bojra per printera dhe fotokopje” me fond limit 8,333,333.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier, ku në përmbatje të saj njofton se ka zbatuar vendimin nr. 412/2026 si dhe ka bashkëlidhur shkresën - “ Shtojcën e modifikuar”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2554/17 prot., datë 30.03.2026, protokolluar me tonën nr. 718/6prot., datë 01.04.2026 autoriteti kontraktor, ka dërguar informacion për procedurën e “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-77633-02-26-2026, me objekt: “Blerje bojra per printera dhe fotokopje” me fond limit 8,333,333.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier, ku në përmbatje të saj njofton se ka zbatuar vendimin nr. 412/2026 si dhe ka bashkëlidhur shkresën - “ Shtojcën e modifikuar”.

II.2. Referuar shkresës të mësipërme, të ardhur nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe pas verifikimeve të kryera, rezulton se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën e modifikuar për procedurën e mësipërme të prokurimit sipas përcaktimeve të Vendimit KPP Nr. 412/2026, datë 24.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-77633-02-26-2026, me objekt: “Blerje bojra per printera dhe fotokopje” me fond limit 8,333,333.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

